



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 si dhe neneve 3, 4 dhe 5 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga buxheti i Komunës Nr.15-011-23133 e datës 06.05.2015, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 1500 (një mijë e pesëqind) euro, Shoqatës sindikale të Minierave " Goleshi", nga Magura ,sipas kërkesës së tyre të datës 27.01.2016.

Shuma e cekur në paragrafin paraprak i ipet si mbështetje financiare me rastin e shënimit të përvjetorit të javës së minatorëve që planifikohet të fillojë me 20 - 28 shkurt 2016.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2016, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare nr.1501080001485192 në Raiffaissen Bank.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara pas mbajtjes së manifestimit , Shoqata sindikale e Minierave " Goleshi" duhet të sjell raport financiar mbi mjete e shpenzuara duke i bashkëngjitur edhe faturat më së largu me datë 31.03.2016 dhe të njëjtat ti dorëzojë në Zyrën e Kryetarit të Komunës - Sektorin për përfaqësim dhe çështje ligjore.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Shoqata sindikale e Minierave " Goleshi" në Magurë.

1Nr. 400-4166

Lipjan, më 03.02.2016

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

